



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, dt. 20.02.2008, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, për ndërtim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 18/2012), neneve 14 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L - 049, për financat e pushtetit lokal, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2016, nxjerr këtë:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES
MBI TAKSËN ADMINISTRATIVE PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT DHE
TARIFËN PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS 01-434/01-0094474/17 dt.
24.04.2017**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i i kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores mbi taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës 01-434/01-0094474/17.

Neni 2

Neni 13 i rregullores bazike fshihet dhe riformulohet si ne vijim:

Mënyra dhe afatet e pagesës

13.1 Pagesa e taksës administrative dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës sipas kësaj rregulloreje, paguhet ne teresi ne afat pesë (5) ditësh pas pranimit te aktvendimit për llogaritjen e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.

13.2 Vendimi për lejen e ndërtimit nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e kompensimit të caktuar në aktvendimin për caktimin e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.

13.3 Nëse pagesa e kompensimit të llogaritur nuk bëhet brenda afatit të paraparë sipas paragrafit 13.1 te këtij neni, do të pasojë refuzimi i kërkesës për dhënie e lejes së ndërtimit.

13.4 Ushtrimi i mjetit juridik në Vendimin mbi llogaritjen e taksës sipas kësaj rregullore apo kërkesa për rishqyrtim, nuk e shtyn afatin për pagesë të parapare ne paragrafin 13.1, e as nuk i ndalon veprimet e organit të parapara në paragrafin 13.3,të këtij neni.

13.5 Për aplikuesit të cilëve iu miratohen kërkesat për leje të ndërtimit, kjo shumë do të jetë pjesë e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, ndërsa aplikuesve të cilëve iu refuzohet kërkesa, kjo taksë nuk do të iu kthehet, pasi që organi krijon shpenzime në shqyrtim të aplikacionit.

Neni 3 Dispozitat kalimtare

Procedurat administrative për marrjen e lejeve ndertimore të filluara dhe të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të vazhdojnë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina